

Kodi i Etikës së Delta Galil

QËLLIMI

Ky kod i etikës është përpiluar për të përcaktuar kërkesat minimale të të bërit biznes me filialet e Delta Galil Industries Ltd. ("Delta Galil"). Pritshmëria e Delta Galil është që të gjithë ofruesit të kryejnë një vlerësim të rrezikut në lidhje me të gjitha klauzolat e përcaktuara në këtë Kod dhe t'ua komunikojnë këtë politikë furnitorëve, materialet ose të hyrat e të cilëve përfshihen në mallrat e shitura te Delta Galil për të zbutur paraprakisht në mënyrë aktive rreziqet përmes boshllëqeve dhe fushave të mundshme për përmirësim.

DETYRIMI LIGJOR

Delta Galil dhe filialet e saj do të bëjnë biznes vetëm me kontraktorë, furnitorë, shitës dhe agjentë të autorizuar, të cilësuar këtu si "Furnitorë" që veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e në fuqi të juridiksionit ku ata veprojnë dhe në juridiksionet ku tregtohen mallrat e saj. Delta Galil nuk do të tolerojë asnjë mosrespektim të ligjit nga punonjësit ose partnerët e saj të biznesit dhe kërkon që punonjësit dhe partnerët e saj të raportojnë menjëherë çdo shkelje të dyshuar të ligjit ose rregullores. Në të gjitha rastet kur ka dallime ndërmjet këtij kodi, kodit të klientit përkatës dhe ligjit, atëherë për bazë do të merret standardi më i lartë.

TRANSPARENCA

Pritshmëria e Delta Galil është që të ketë transparencë të plotë në të gjitha çështjet gjatë bashkëpunimit. Të gjithë furnitorët dhe punonjësit duhet të veprojnë me etikë në praktikën e tyre të biznesit. Furnitorët do të ruajnë në fabrikat për një periudhë 5-vjeçare të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar se ai është në përputhje me këto standarde, duke përfshirë, por nuk kufizohet në, kërkesat e mbajtjes së të dhënave sipas marrëveshjes me Delta Galil. Delta Galil do të ndërmarrë masa afirmative si inspektime të lajmëruara ose të paparalajmëruara në fabrika për të monitoruar nëse këto standarde janë në përputhje. Furnitorët duhet t'u japin përfaqësuesve të Delta Galil qasje të plotë në fabrika, në të dhënat e punonjësve dhe që punonjësit të intervistohen në mënyrë konfidenciale në lidhje me vizitat monitoruese. Për më tepër, Furnitorët duhet t'u përgjigjen menjëherë kërkesave të arsyeshme të përfaqësuesve të Delta Galil në lidhje me çështjet e referuara në revizion (audit). Në rast të refuzimit të qasjes së plotë ose përgjigjeve ndaj kërkesave të arsyeshme, atëherë kjo do të sillte sanksione ose ndërprerjen e marrëdhënieve të biznesit me furnitorët. Për më tepër, Delta Galil është e përkushtuar të njohë furnitorët e saj në të gjitha hallkat e zinxhirit të saj të furnizimit. Pritshmëria e Delta Galil është që furnitorët e saj ta përforcojnë këtë angazhim, duke ndihmuar në hartimin e të gjithë zinxhirit të furnizimit të prodhimit të artikujve për Delta Galil.

MARRËDHËNIA E PUNËS

Furnitorët duhet të miratojnë dhe të respektojnë rregullat dhe kushtet e punës në dobi të punonjësve dhe, së paku, të mbrojnë të drejtat e tyre sipas ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të punës dhe sigurimeve shoqërore. Të gjithë punonjësit duhet të informohen për kushtet e përgjithshme të punësimit të tyre përpara fillimit të punës.

MOSDISKRIMINIMI

Ndërsa Delta Galil pranon dhe respekton ndryshimet kulturore, punësimi duhet të bazohet në aftësi dhe jo thjesht në bazë të një besimi ose të ndonjë veçorie tjetër personale. Delta Galil është mjaft e përkushtuar që të trajtojë të gjithë punonjësit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Kandidatët dhe punonjësit do të vlerësohen në bazë të aftësive, kualifikimeve dhe arritjeve të tyre. Furnitorët nuk duhet të diskriminojnë gjatë punësimit, kompensimit, promovimit, disiplinimit, shkarkimit ose daljes në pension, duke përfshirë edhe diskriminimin në bazë të grupit social,

originës etnike, racës, gjinisë, orientimit seksual, fesë, originës kombëtare, moshës, aftësive të kufizuara ose ndonjë veçori tjetër.

PUNA E DETYRUAR

Furnitorët nuk do të përdorin të burgosurit ose mënyra të tjera skllavërie ose pengu në formë shërbimi ose shlyerje borxhi për punë të detyruar. Asnjë punonjësi nuk do t'i kërkohej para në këmbim të punësimit. Të gjitha kostot dhe tarifat që lidhen me rekrutimin ose shqyrtimin e punonjësve duhet të mbulohen nga punëdhënësi dhe të mos u ngarkohen punonjësve. Punonjësit duhet të kenë nën zotërim dokumentet e tyre të udhëtimit dhe të lëvizin lirisht. Furnitorët duhet të informojnë për mungesën e të gjithë treguesve të punës së detyruar siç përshkruhet në Treguesit e Punës së Detyruar të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Kërkesat e mëtejshme përshkruhen hollësisht në certifikimin e punës së detyruar të Delta Galil, që duhet të kuptohen dhe të nënshkruhen nga të gjithë furnitorët e Delta Galil. Të gjitha pikat në certifikimin e punës së detyruar të Delta Galil janë unifikuar në këtë Kod.

PUNËSIMI I FËMIJËVE

Furnitorët ndalohen të marrin në punë persona nën 15 vjeç ose nën moshën sipas ligjit kombëtar, ose nën moshën e kryerjes së arsimit të detyruar, cilido nivel qoftë më i lartë. Punonjësit nën 18 vjeç duhet të punësohen në përputhje me rregulloret lokale për punëtorët e rinj.

E DREJTA E ANËTARËSIMIT DHE NEGOCIMI KOLEKTIV

Furnitorët duhet të njohin dhe respektojnë të drejtën e punonjësve për t'u anëtarësuar lirisht, për të negociuar kolektivisht dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre pa pasur frikë nga ndërhyrjet, kanosjet, ngacmimet ose hakmarrjet. Furnitorët duhet ta njohin këtë të drejtë edhe në shtetet ku e drejta për anëtarësim dhe negociata kolektive kufizohet nga ligji vendas.

MEKANIZMI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Furnitorët duhet të sigurojnë që punonjësit të kenë qasje në mekanizmat e efektshëm të ankesave, të cilat përfshijnë mënyra të shumta raportimi, prej të cilave njëra të paktën duhet të jetë konfidenciale.

NGACMIMI DHE ABUZIMI

Punonjësit kanë të drejtën të punojnë në një mjedis ku nuk u nënshtrohen abuzimeve verbale, psikologjike dhe fizike, kanosjeve, ngacmimeve seksuale, shfrytëzimeve, sulmeve ose poshtërimeve nga çdo punonjës tjetër, mashkull apo femër, pavarësisht nga pozicioni që ai/ajo ka në kompani; furnitorët duhet t'i trajtojnë të gjithë punonjësit me dinjitet dhe respekt.

ORËT E PUNËS DHE PUSHIMI

Furnitorët duhet të sigurojnë që orët e punës së punonjësve të mos jenë përtej kufizimeve ligjore për orarin e rregullt të punës dhe jashtë orarit në juridiksionin ku ata veprojnë. Orari i rregullt javor i punës nuk duhet të kalojë 48 orë. E gjithë puna jashtë orarit duhet të bëhet me marrëveshje të ndërsjellë. Furnitorët nuk do të kërkojnë nga punonjësit që të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës, dhe do t'i kompensojnë për të gjitha orët shtesë me një tarifë ekstra. Me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, totali i orëve të rregullta të punës dhe orët shtesë në javë nuk do të jetë më shumë se 60 orë. Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e të paktën një dite pushimi, e barabartë me 24 orë pa shpëputje, pas çdo periudhe shtatëditore.

KOMPENSIMI

Furnitorët duhet t'i kompensojnë punonjësit e tyre në mënyrë të drejtë, duke ofruar paketa kompensuese të cilat të plotësojnë të paktën standardet minimale ligjore ose normën

mbizotëruese të pagës, cilado qoftë më e lartë, dhe të sigurojnë të gjitha përfitimet ekstra sipas ligjit ose kontratës. Punonjësit duhet të kompensohen plotësisht për orët shtesë në përputhje me ligjin vendas dhe çdo punonjës duhet të pajiset me një raport të qartë dhe me shkrim për çdo periudhë pagese. Kur kompensimi nuk është i mjaftueshëm për nevojat bazë të punonjësve dhe nuk siguron disa të ardhura diskrecionale, Furnitorët duhet të punojnë për të ndërmarrë veprime të duhura që synojnë të realizojnë në mënyrë progresive një nivel të arritshëm kompensimi.

SHËNDETI DHE SIGURIA

Furnitorët duhet të kenë sisteme në dispozicion për të identifikuar, parandaluar dhe ulur paraprakisht në mënyrë aktive rreziqet për sigurinë e të gjithë punonjësve. Furnitorët duhet t'u ofrojnë punonjësve të tyre një mjedis të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm pune, të përshtatshëm për të parandaluar aksidentet dhe lëndimet shëndetësore që shkaktohen ose ndodhin gjatë procesit të punës ose si rezultat i veprimtarisë së fabrikave të punëdhënësit. Këtu përfshihen mbrojtja nga zjarri, aksidentet dhe substancat toksike; sistemet e ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit duhet të jenë të mjaftueshme. Nga Furnitorët kërkohet që të respektojnë të gjitha standardet në fuqi, të detyrueshme me ligj lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës në shtetet dhe komunitetet ku veprojnë. Këto standarde vlejnë edhe për punonjësit, të cilëve iu është siguruar strehimi.

MJEDISI

Furnitorët duhet të menaxhojnë dhe të punojnë për të reduktuar rreziqet që kanë të bëjnë me ndikimet klimatike si energjia, uji, mbeturinat, ujërat e zeza, emetimet në ajër dhe lëndët kimike. Furnitorët duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e mjedisit në shtetet ku ata veprojnë. Furnitorët duhet të miratojnë masa të përgjegjshme për të zbutur ndikimet negative të furnitorit mbi mjedisin.

SIGURIA

Furnitorët duhet të miratojnë procedura të sigurisë për të ndaluar futjen e artikujve të palejuar në dërgesat për transport jashtë. Artikuj të tillë përfshijnë lëndë narkotike, agjentë biologjikë, eksplozivë, armë, materiale radioaktive, të huaj të paligjshëm dhe mallra të tjera kontrabandë. Delta i pranon Udhëzimet e Partneritetit Doganë-Tregti kundër Terrorizmit (CTPAT) të Mbrojtjes së Doganave dhe Kufirit të Shteteve të Bashkuara (CBP) për Prodhuesit e Huaj si kërkesa minimale të zbatueshme për të gjitha shtetet importuese.

TË DREJTAT E GRAVE

Furnitorët duhet të sigurojnë që punonjëset do të shpërblehen, duke përfshirë përfitime; të trajtohen dhe të vlerësohen njësoj në cilësinë e punës së tyre dhe të kenë mundësi të barabarta për t'u punësuar në të gjitha pozicionet e lira për meshkujt. Testet e shtatzënisë nuk do të jenë kusht për punësim dhe as nuk do të kërkohen nga punonjëset. Punonjëset që marrin lejen e shtatzënisë (për një periudhë kohore të përcaktuar sipas ligjeve lokale dhe kombëtare) nuk do të largohen nga puna, as të kërcënohen me largim nga puna, nuk do të humbin vjetërsinë në punë ose të kenë reduktim page dhe do të jenë në gjendje të rikthehen në vendin e tyre të mëparshëm të punës me të njëjtin nivel page dhe përfitime. Punonjëset nuk do të detyrohen ose nuk do t'u nënshtrohen presioneve për të përdorur kontraceptivë. Punonjëset nuk do të ekspozohen ndaj rreziqeve, duke përfshirë ngjitësit dhe tretësit që mund të rrezikojnë sigurinë e tyre, si dhe shëndetin e tyre riprodhues. Furnitorët do t'u ofrojnë grave shërbime dhe kushte të duhura lidhur me shtatzëninë e tyre.

NËNKONTRAKTIMI

Furnitorët nuk do të përdorin nënkontraktorë për prodhimin e artikujve ose komponentëve të

Delta Galil pa miratimin me shkrim të Delta Galil dhe vetëm pasi nënkontraktori të këtë rënë dakord se do të respektojë këtë Kod të Etikës.

Përgjegjësia për shkeljen e këtyre parimeve, do të bjerë mbi Furnitorin, i cili do të mbulojë kostot për këtë qëllim. Delta Galil rezervon të drejtën të marrë masat e nevojshme për të siguruar që këto standarde të respektohen në të ardhmen. Mosrespektimi i këtyre standardeve do të sjellë përfundimisht ndërprerjen e marrëdhënies midis Delta Galil dhe Furnitorit të autorizuar.